


NDËRTIMI I SISTEMIT PENSIONAL në Kosovë

CONSTRUCTION OF THE
PENSION SYSTEM in Kosova



 **KDI**
Instituti Demokratik i Kosovës
Kosova Democratic Institute
www.kdi-kosova.org

Qëndrimet e shprehura në këtë publikim janë ato të KDI-së dhe jo domosdoshmërisht paraqesin ato të donatorëve.

PERSONELI

Ismet KRYEZIU - Drejtor Ekzekutiv

email: ikryeziu@kdi-kosova.org

Vjollca VOGËL - Menaxhere e administratës dhe financave

email: vjollca@kdi-kosova.org

Leonora CIKAJ - Asistente për administratë dhe financa

email: lcikaj@kdi-kosova.org

Donjeta DRESHAJ - Asistente për administratë dhe financa

email: ddreshaj@kdi-kosova.org

Arsim Gjinovci - IT & Design

email: agjinovci@kdi-kosova.org

**PROGRAMI: DEMOKRATIZIMI DHE
PRAKTIKAT PARLAMENTARE**

Driton SELMANAJ - Menaxher i programit

email: dselmanaj@kdi-kosova.org

Isuf ZEJNA - Asistent i projektit

email: izejna@kdi-kosova.org

Ganimete HESETI - Vëzhguese e parlamentit

email: gheseti@kdi-kosova.org

**PROGRAMI: QEVERISJA LOKALE DHE
PJESËMARRJA QYTETARE**

Kreshnik BASHA - Koordinator

email: kbasha@kdi-kosova.org

Naim CAHANAJ - Koordinator

email: ncahanaj@kdi-kosova.org

PROGRAMI: TRANSPARENCA DHE ANTIKORRUPSIONI

Merita MUSTAFA - Menagjere e programit

email: mmustafa@kdi-kosova.org

Enis XHEMAILI - Kryesues i hulumtimit

email: exhemaili@kdi-kosova.org

Besnik RAMADANAJ - Asistent i projektit

email: bramadanaj@kdi-kosova.org

Natyra KASUMAJ - Koordinatore

email: nkasumaj@kdi-kosova.org

PROGRAMI: ZGJEDHJET E LIRA DHE TË DREJTA

Liridon SELMANI - Menaxher i programit

email: lselmani@kdi-kosova.org

Përmbajtja:

4

1.	Hyrja	5
2.	Gjendja aktuale dhe baza legale që e mbulon këtë fushë	6
	2.1 Cilat janë sfidat e modelit aktual pensional?	7
	2.2 Mungesa e ligjeve të cilat kompletojnë sistemin pensional në Kosovë	10
3.	Fondi Pensional	10
4.	Shembujt dhe praktikat e mira në ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm pensional	11
5.	Reformat pensionale që duhet aplikuar në Kosovë	13
6.	Rekomandimet	15
7.	Burimet	16

Hyrje

Neni 23 Dinjiteti i Njeriut (Kushtetuta e Republikës së Kosovës)

Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriu

Neni 25 E Drejta për Jetën

Secili individ gëzon të drejtën për jetën¹.

Këto janë dy dispozita që janë përfshirë në aktin më të lartë juridik dhe politik të vendit tonë - Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Të drejtat e tilla janë të normuara dhe si të tilla sjellin detyrime për të gjitha organet dhe institucionet e Republikës së Kosovës karshi qytetarëve të saj. Normat e tilla janë njëkohësisht edhe detyrime për organizim të sjelljeve të vetëdijshme të secilit qytetarë ndaj tjetrit pa marrë parasysh çdo lloj dallimi individual ndërmjet tyre. E drejta e pensionit si një e drejtë e fituar absolute duhet të gëzojë edhe mbrojtje absolute nga të gjitha institucionet kompetente. Mohimi i një të drejte të tillë, është mohim i mbrojtjes së dinjitetit të qytetarëve të cilët për shumë vite kontribuan në ndërtimin e vendit.

Në praktikë kjo çështje nuk është e rregulluar vetëm me ligje sistemore dhe me kushtetuta të shteteve por edhe me norma të së drejtës ndërkombëtare. Fatkeqësisht Kosova nuk ka ligje të mjaftueshme dhe akoma nuk ka ndërtuar një sistem pensional të konsoliduar edhe pse ka kaluar një dekadë, që nga konstituimi i institucioneve demokratike të Kosovës. Gjatë gjithë kësaj periudhe kjo shtresë e shoqërisë (pensionistët) është nëpërkëmbur deri në mos-durim. Neglizhenca e institucioneve dhe e klasës politike për ta trajtuar këtë problematikë e ka bërë edhe më të vështirë jetën dhe mirëqenien e mbi 130.000² pensionistëve të Kosovës.

Në krahsim me vendet e rajonit, në Kosovë ekziston një problem jo shumë tipik me vendet tjera, që është informaliteti i skajshëm. Sektori privat pothuajse tërë veprimtarinë e tij e ka "gri", dhe ka të lajmëruar vetëm një pjesë të kufizuar të punëtorëve, ashtu siq është në trend edhe ikja nga pagimi i taksave.

Po ashtu si në as një vend tjetër të rajonit, kontribuesit në fondin e ish Federatës Jugosllave, në Kosovë paguhen me një pension tejet simbolikë gjë e cila atyre nuk u mundëson të jetojnë as për së afërmi një jetë dinjitoze. Në secilën nga vendet e rajonit pensionet janë të paktën dyfishi i këtyre që sot marrin pensionistët Kosovarë, prej të cilëve shumë nga ta kanë edhe mbi 45 vite të përvojës së punës.

Në Kosovë shtylla I dhe II e sistemit pensional janë tërësisht të ndara, dhe pensionistët aktual nuk marrin asnjë cent nga kontribuuesit aktual, gjë e cila nuk është e njëjtë me shtetet fqinje. Është e domosdoshme që të veprohet shumë shpejt për këtë pjesë të marginalizuar të shoqërisë që të paktën tani pas kaq shumë vitesh t'i sigurojmë një

¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës

² <http://esk.rks-gov.net> (Të dhënat e Entit të Statistikave e Kosovës për vitin 2007).

pension i cili do t'i bënte ata të ndihen komod në vendin për të cilin ata punuan me aq shumë mund.

Kjo analizë ka për qëllim që të ofrojë të dhëna mbi gjendjen dhe bazën aktuale legale, si dhe të ofrojë të dhëna të mjaftueshme mbi nevojën dhe format që duhen aplikuar në Kosovë me qëllim të ndërtimit të një sistemi pensional të qëndrueshëm, dhe të pranueshëm për qytetarët e Kosovës. Ky punim është ndarë në disa shtylla: fillimisht një përshkrim mbi gjendjen aktuale dhe bazën legale që e mbulon këtë fushë, pastaj mungesa e ligjeve të cilat kompletojnë sistemin pensional në Kosovë, shembujt dhe praktikatat e mira në ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm pensional, format e sistemeve pensionale që duhet aplikuar në Kosovë si dhe në fund janë nxjerrë disa rekomandime konkrete, për veprimet që duhen ndërmarrë nga institucionet kompetente për të përmirësuar pozitën e pensionistëve në Kosovë.

2. Gjendja aktuale dhe baza legale që e mbulon këtë fushë

Që nga periudha e pasluftës në Kosovë rregullimi legal i qështjes së pensioneve ka filluar qysh në vitin 2001 me Rregulloren e UNMIK-u 2001/35 Mbi Pensionet në Kosovë³, duke u pasuar më pas me Rregulloren 2002/15 Për shpalljen e Ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës mbi metodologjinë e caktimit të lartësisë së pensionit bazë në Kosovë dhe caktimin e datës për sigurimin e pensioneve bazë⁴. Më pas Rregullorja 2001/35 ndryshohet shumë sipërfaqësisht me Rregulloren 2005/20 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/35 mbi Pensionet në Kosovë⁵. Së fundmi me 13.06.2008 Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për ndryshimin e Rregullore së UNMIK-ut 2005/20 për ndryshimin e Rregullores 2001/35 për Fondin Pensional të Kosovës⁶.

Në Kosovë Sistemi Pensional për shkak të një mori arsyesh politike dhe sociale është i organizuar në tri shtylla kryesore. Në organizim të tillë ka ndikuar baza legale e pa unifikuar si dhe nevoja për të bërë zgjidhje ad hoc varësisht prej paraqitjes së situatave të presionit nga grupe të caktuara të shoqërisë.

Shtylla I – Përfshinë pensionet bazë, pensionet e parakohshme dhe të veçanta, për kategoritë të cilat nuk kanë kontribuar në fondin pensional.

Shtylla II – Kursimet pensionale në llogari individuale të cilat janë të obligueshme, përkatësisht kontributet në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës, ku punëdhënësi dhe punëmarrësi kontribuojnë me nga 5% secili.

Shtylla III - Janë kursimet suplementare, pjesë kjo e liberalizuar për fondet private, në Kosovë (aktualisht kemi vetëm një).

Në kuadër të shtyllës së parë, e cila përfshinë kategorinë e cila financohet nga buxheti i shtetit janë të përfshirë 1. Sistemi pensional i moshës apo bazik, 2. sistemi pensional i moshës të cilët kanë kontribuar në fondin pensional të kaluar (të gjithë ata që kanë kon-

³ <http://www.unmikonline.org>

⁴ <http://www.unmikonline.org>

⁵ <http://www.unmikonline.org>

⁶ <http://www.assembly-kosova.org>

tribuar mbi 15 vite), 3. Pensionet për persona me aftësi të kufizuara, 4. Pensionet e parakohshme për ish minatorët e kompleksit Trepça dhe 5. Pensionet e veçanta për ish pjesëtarët e TMK-së (pension ky familjar).

Për pensionistët e moshës, Ministria aplikon një sistem të integruar të IT-së i cili kërkon që secili pensionist të paraqitet ç' do 6 muaj për të dëshmuar se është i gjallë, kjo për të pamundësuar keqpërdorimin e këtyre pensioneve nga persona të pa ndërgjegjshëm të cilët vazhdojnë të marrin pensionet edhe për persona të vdekur. Për shkak të mos lajmërimeve të tilla, ministria ka zyrtarë të cilët janë përgjegjës për t'i hetuar këto raste e të cilët angazhohen në terren duke marr informata nga lajmërimet e rasteve të vdekjes, përkujtimet në gazetë etj⁷.

Aktualisht në Kosovë nga shtylla e I, përfitues janë 162.387 persona, prej të cilëve janë suspenduar 4133 për shkak të mos lajmërimit tek zyrtarët përgjegjës, edhe pas kalimit të afatit 6 mujor. Gjithësejtë mjete të alokuara nga buxheti i Kosovës për këto pensione janë ndarë rreth 122 milion euro⁸.

Ky sistem sipas përfaqësuesve të ministrisë ka qenë rezultat i rrethanave të pasluftës dhe i ngjanë shumë sistemit britanik.

Dardan Sejdiu - Drejtor i Përgjithshëm i Fondit Slloveno-Kosovar për pensione, njëherit edhe njohës i mirë i kësaj fushe, vlerëson se gjendja aktuale e sistemit pensional në Kosovë është vendosur në vitin 2001, duke bërë një prerje të menjëhershme të në mes dy formave të rregullimit të sistemit pensional, pra duke bërë një tranzicion të vështirë dhe jo fer, nga sistemi i gjeneratave në atë të vetëfinancimit dhe kështu është lënë anash një gjeneratë e tërë e pensionistëve ekzistues, ku i kanë fuzionuar të dy skemat atë sociale dhe skemën pensionale. Sipas tij Kosova ka ndërtuar një bazë të legjislacionit themelor, por ka dështuar në ndërtimin e sistemit pensional në Kosovë.

2.1 Cilat janë sfidat e modelit aktual pensional?

a. Shtylla e parë

• Pensionet e ulëta

Në shtyllën e parë të sistemit pensional të Kosovës, ka vetëm dy kategori për sa i përket shkallës së pensioneve. Pensionet e moshës janë në vlerë 45 euro dhe pensionet për personat të cilët dikur kanë kontribuar në fondin pensional mbi 15 vite, dhe të cilët marrin shumë prej 80 eurove. Që të dy këto kategori janë larg standardit të jetës në Kosovë, dhe as për se afërmi nuk i përmbushin nevojat e këtyre pensionistëve të cilët, përveq jetës së kushtueshme për ushqim dhe shërbime publike kanë nevoja të shtuara për shërbimet medicinale, të cilat në të shumtën e rasteve duhet të kryehen në sektorin privat, ku qmimet janë astronomike.

⁷ Intervistë personale, Sami Salihu, Drejtor i Departamentit të Administratës Pensionale/ MPMS

⁸ Intervistë personale, Sami Salihu, Drejtor i Departamentit të Administratës Pensionale/ MPMS

- **Shkallëzimi i pensioneve**

Pavarësisht kohës që një kontribuues ka kapitalizuar mjete në fondin e kaluar pensional dhe pavarësisht lartësis së pagës, ç' do person që ka mbi 15 vite përvojë punë ka të njëjtin pension. Kjo është e pa drejt ndaj atyre kategorive që kanë pasur paga të larta dhe për personat që kanë kontribuar për shumë vite, pasi ata të gjithë janë barazuar me po të njëjtën shumë. Është e domosdoshme që krahas rritjes edhe shuma e pensioneve të përshkallëzohet edhe më tutje, duke i kategorizuar më mirë të gjithë ata pensionist, varësisht prej lartësis së pagës që kanë pasur dhe varësisht prej përvojës së punë⁹.

- **Pastrimi i listave të pensionistëve**

Një numër i madh i personave të cilët vdesin, familjarët e tyre nuk i lajmrojnë ata dhe pensionet për ta vazhdohet të merren edhe më tutje nga familjarët e tyre. Ministria ka aplikuar një formë të lajmrimit ç' do gjashtë muaj në Bankën Komerciale ku ata duhet të nënshkruajn një deklartatë në mënyrë që të vërtetohet se ata janë të gjallë. Po ashtu zyrtar të ministrisë hetojnë rastet e vdekjes se personave për të pastruar listat, duke i përcjellur njoftimet për vdekje, përkujtimet në gazeta etj. Kjo ka shtuar shpenzimet për Ministrinë e linjës dhe po ashtu ka komplikuar jetën pensionistëve të cilët në shumë raste presin me ditë të tëra para bankave komerciale për të nënshkruar deklaratat në mënyrë që të mos suspendohen nga lista e përfituesve të pensioneve. Certifikatat e vdekjes nuk nxirren me kohë nga familjarët e po ashtu nuk ka një koordinim të duhur ndërmjet dy ministrive për të azhurnuar ato lista. Certifikatat e vdekjes nxirren me procedura burokratike dhe po ashtu duhet paguar taksë për to, kjo ndikon që familjarët të zhargisin nxjerrjen e një certifikate të tillë, ndërsa për buxhetin e shtetit kjo është barrë shtesë e cila duhet hetuar dhe gjetur për të evituar pagesat e më tutjeshme.

- **Mosha e pensionimit për të dy gjinitë**

Legjislacioni ynë aktual ka përcaktuar moshën 65 vjeqare si moshë e pensionimit për të dyja gjinitë, ndërkohë bazuar në praktikat dhe legjislacionin e vendeve të rajonit dhe më gjerë kjo moshë dallon, ku gjinia femërore gëzon pensionim para moshës 65 vjeqare.

b. Shtylla e dytë

- **Shuma e kontributeve**

Kosova ka përqindjen më të ulët të kontributeve në rajon, kjo ndikon që edhe masa e përgjithshme e mjeteve që ka Trusti nën administrim të jetë më e vogël sesa që kanë vendet e rajonit. Vendet si Kroacia dhe Bullgaria të cilat reformën e sistemit pensional e kanë filluar pothuajse në të njëjtën kohë me vendin tonë, kanë arritur që shumën e mjeteve të kapitalizuara ta kenë shumë të lartë në krahasim me ne. Kroacia e cila ka filluar reformën në vitin 2002 tani ka rreth 4.9 miliard euro të kapitalizuara, kurse Bullgaria e cila ka filluar reformën në vitin 2000 ka të kapitalizuara rreth 3 miliard. Kurse Kosova ka ngelur në shifra 495 milion euro.

⁹ Intervistë personale, Zineta Daci, Oda Ekonomike e Kosovës

- **Kombinimi i fondeve**

Kosova është i vetmi vend në rajon ku kontribuesit aktual nuk paguajn mjete edhe për gjeneratën e pensionistëve të tanishëm¹⁰. Duke e marrë për bazë edhe vjedhjen e fondit të kaluar nga shteti serb, dhe pa mundësinë e gjetjes së një zgjidhje tjetër, Kosova ka nevojë më shumë se cili do vend tjetër që gjenerata të ndihmoj aq sa është e mundur pensionistët aktual.

- **Informaliteti**

Administrata tatimore dhe Trusti i pensioneve të Kosovë, duhet që së bashku të bëjnë më shumë në sensibilizimin e qytetarëve për të kontribuar në Trust, pasi që kjo do të ndikojë shumë në faktin se çfarë standardi do të kenë punëtorët e sotëm, pas disa viteve kur ata do të bëhen pensionist. Gjithashtu ATK duhet të bëjë shumë më tepër që të ndëshkoj dhe të vëj në rend bizneset të cilat nuk i paraqesin punëtorët e tyre, duke i'u shmangur pagesës së taksave.

Në Trustin e Pensioneve të Kosovës ka 234,729 kontribuues aktiv përderisa numri total i të punësuarve paramendohet të jetë rreth 500 000 (shifër jo zyrtare), që do të thotë se më shumë se gjysma e të punësuarve apo e atyre që ekonomizojnë sot nuk paguajnë kontribute, kryesisht si rezultat i pagave të vogla dhe mos gatishmërisë së punëdhënësve që të kryejn obligimet ligjore ndaj punëtorëve dhe Qeverisë. Në vendet e rajonit, kontributet pensionale paguhen edhe nga bujqit madje edhe personat e tjerë të cilët kanë të ardhura apo ekonomizojnë edhe pa pasur një vend të rregullt pune¹¹, kjo gjë nuk ndodhë edhe në Kosovë. Pas një kohe mund të ndodhë që në Kosovë paqja sociale të mos mund të mbahet e qëndrueshme pikërisht nga shkakun se një numër i madh i njerëzve mund të mbesin jashtë benefiteve nga fondi pensional¹².

- **Monopoli i operatorit të kursimeve**

Aktualisht kthimi i mjeteve nga Trusti nuk është gjithaq progresiv dhe humbejt nga vitet e kaluara nuk janë ri-koperuar në tërësi. Do të ishte e preferueshme që kontribuesve t'u ipej mundësia të zgjedhin në mes disa operatorëve se ku do t'i investojnë mjetet e tyre, duke llogaritur secili në efektivitetin e kthimit të investimeve. Në këtë formë konkurrenca do të ndikonte mbase edhe të shtohen numri i kontribuesve, pasi operatorët do të investonin më tepër në marketing dhe do të bënë presion mbi ATK-në që të filloj fushatë më agresive të mbikëqyrjes së sektorit privat për sa i përket formalitetit të punës së tyre. Në favor të liberalizimit të tregut flet edhe Dardan Sejdiu i cili thotë se meqë qytetarët obligohen të kursejnë atëherë atyre duhet dhënë mundësia që të zgjedhin se në cilin fond pensional duhet të kursejnë. Sistemi aktual i obligon qytetarët për kursim por nuk i garanton, kështu që trusti mund ti humb mjetet dhe askush nuk garanton për humbjet, andaj meqë rrisi mbi qytetarin atëherë dhe zgjedhja duhet të jetë e vet qytetarëve që të zgjedhin mes dy apo tre operatorëve që merren me kursime individuale mandatore, shton më tej z. Sejdiu¹³.

¹⁰ www.iopswweb.org

¹¹ www.coe.int

¹² Intervistë personale, Alban Hashanin - Drejtor i Hulumtimeve në Institutin Ri-Invest

¹³ Intervistë personale, Dardan Sejdiu - Drejtor i Fondit Kosovaro-Slloven

c. Shtylla e tretë

10

Qeveria e Kosovës dhe Banka Qendrore, duhet të shtojnë masat për të siguruar se operatorët privat suplementarë nuk do t'i tjetërsojnë paratë e kontribuesve për të mos ardhur deri të ndonjë mashtrim i atyre që me vetë dëshirë vendosin të kontribuojnë nga paga e tyre në këta operatorë.

2.2 Mungesa e ligjeve të cilat kompletojnë sistemin pensional në Kosovë.

Mungesa e legjislacionit i cili ka ardhur si pasojë e përkushtimit minimal të klasës politike në vend, ka sjellur si rezultat që Kosova edhe më tutje të mos ndërtojë një sistem pensional që bazohet në vlera dhe standarde ndërkombëtare. Me qëllim të ndërtimit të këtij sistemi të qëndrueshëm dhe kredibilë, institucionet e Kosovës duhet të miratojnë një pako të ligjeve të cilat e rregullojnë gjithë sistemin pensional në vend. Kompleksiteti i kësaj çështje nuk mund të rregullohet vetëm me Ligjin për Pensionet, por kësaj i nevojiten edhe ligjet tjera përcjellëse të cilat normojnë të drejtat e pensionistëve invalidor, stazhin e beneficuar, kategoritë që gëzojnë pensionimin suplementar etj.

Arsyet e mungesë së ligjeve që garantojnë ndërtimin e një sistemi pensional të qëndrueshëm sipas Dardan Sejdiut, lidhen ngushtë me mungesën e vullnetit politik të institucioneve dhe klasës politike në vend, sepse nuk ekziston asnjë barrierë tjetër¹⁴.

3. Fondi Pensional

Aktualisht Trusti ndjek një politikë investuese konservative duke i investuar mjetet në tregje me nivel të "sigurisë së lartë". Përpjesëtimi maksimal i mjeteve të tërësishme të pensionit, që mund të investohen në mjetet e një emetuesi, duke përfshirë llogaritjen e mjeteve të partnerëve, është pesë për qind (5%)¹⁵. Kjo do të thotë se pavarësisht suksesit të kthimit të mjeteve dhe fitimeve në një entitet nuk mund të rritet shumica e mjeteve të investuara. Kjo ka ndikuar që mjetet e Trustit të jenë bukur shumë të shpërndara në entitet të cilat investohen.

Sipas ligjit të aplikueshëm, fondet e trustit mund të investohen në: 1. Bonothesar, 2. Aksione dhe 3. Garancione bankare. Dy të parat nuk janë të aplikueshme në Kosovë, andaj kjo ka ndikuar që edhe sasia e mjeteve të investuara të jetë simbolike. Në Kosovë, janë investuar më pak se 5% e mjeteve të përgjithshme të Trustit, dhe kjo për shkak të disa arsyeve. 1. Bankat nuk janë treguar shumë të interesuar të marrin para nga Trusti për shkak të likuiditetit të tepruar. Shembull konkret është Procredit Bank me të cilën nuk është vazhduar kontrata e afatizimit të mjeteve prej 5 milion, për shkak se këta të fundit nuk kanë patur interes t'i mbajnë edhe më tutje këto mjete. Arsyeja e dytë është se dy nga tre mekanizmat ku mund të investohen në Kosovë nuk janë ende të aplikueshëm, edhe pse është folur për progres në këtë drejtim. Për sa i përket bazës legale deri më tani ato nuk janë shfrytëzuar. Shteti kroat ka 80% të mjeteve të përgjithshme të kontributeve të kapitalizuara të investuara brenda Kroacisë dhe vetëm 20 është limit i mjeteve për të cilat operatorët mund të vendosin se a t'i investojnë jashtë vendit apo jo.¹⁶

¹⁴ Intervistë personale, Dardan Sejdiu – Drejtor i Fondit Kosovaro-Slloven.

¹⁵ Raporti vjetor I Trustit të Kursimeve Pensionale

¹⁶ Intervistë personale, Agron Krasniqin, Zv-Drejtor në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës

Duke u mbështetur në rekomandimet e palëve të interesit, rekomandohet që mjetet e fondit pensional të kthehn sa më shpejtë në Kosovë që të vihen në funksion të zhvillimit ekonomik të Kosovës¹⁷. Kjo natyrisht se duhet shoqëruar me reformë ligjore, duke i hapur rrugën këtij kthimi të mjeteve i cila aktualisht pengesë e ka Ligjin dhe vullnetin politik për të ndryshuar këtë Ligj. Lidhur me Ligjin për Pensionet ka pasur disa tentativa për të ndryshuar dhe deri më tani nuk është gjetur ndonjë harmoni në mes të institucioneve kompetente vendore dhe faktorëve me ndikim në qështjet monetare në Kosovë, si Banka Botërore. Së fundi, në mandatin e kaluar, Komisioni për Buxhet dhe Financa i pati rekomanduar Kuvendit të Kosovës që krahas shqyrtimit të raportit të miratohet rekomandimi për të filluar rishqyrtimin e Ligjit për Pensionet dhe përkundër faktit se Kuvendi pati autorizuar Komisionin, ky i fundit ishte tërhequr nga ky pozicion duke konstatuar se kjo është punë e vështirë dhe Komisioni nuk mund ta bëjë këtë, pasi nuk i ka kapacitetet e duhura¹⁸.

4. Shembujt dhe praktikat e mira në ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm pensional

* Sistemi pensional i Zvicëran

Në këtë vend aplikohet model në tri shtylla i pensioneve. Shtylla e parë është modelit pay-as-you-go, përderisa shtylla e dytë e njohur si "LPP" është e detyrueshme dhe e bazuar në investime. Kjo njëherit është shtyllë e liberalizuar ku vepron disa operatorë. Shtylla e tretë, është e bazuar në pensionet suplementare dhe është shtyllë vullnetare¹⁹.

Shtylla e parë "AVS", i cili është kontribut i detyrueshëm për të gjithë të punësuarit, në këtë shtyllë përfitues janë të gjithë të moshuarit, ky pension është familjar dhe në rast të vdekjes është i trashëgueshëm. Ky sistem është i obligueshëm për të gjithë personat të cilët kanë mbushur moshën 20 vjeçare, e në rast se jeni i punësuar edhe para kësaj moshe, deri në 17 vjeç. Shuma e pensionit në këtë shtyllë varion nga 1160 (CHF) minimale, e deri në 2320 (CHF) maksimale. Moshë e pensionimit është 65 vjeç për meshkuj, ndërsa 64 për femra²⁰.

Shtylla e dytë, është shtyllë e detyrueshme e bazuar në investime dhe është shtyllë e liberalizuar ku vepron shumë operatorë të tillë privat. Kjo shtyllë ka për qëllim të kompletoj pensionet në mënyrë që të mbajë një standard sa më të lartë për pensionistët zvicëran. Kontributet varësisht nga lartësia e pagës janë 7-18% e pagës. Ky model është i obligueshëm që nga viti 1985.

Shtylla e tretë, është vullnetare dhe kontribuuesit mund të zgjedhin me vetë dëshirë nëse do të kontribuojnë apo jo. Ajo që është domethënëse është se ata të cilët vendosin të kontribuojnë në shtyllën e tretë kanë zbritje dhe lehtësira në tatimet.

¹⁷ Intervistë personale, Alban Hashanin - Drejtor i Hulumtimeve në Institutin Ri-Invest

¹⁸ Raporti i monitorimit të Punës së Kuvendit të Kosovës - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI)

¹⁹ <http://www.justlanded.com/english/Switzerland/Switzerland-Guide/Jobs/Old-age-insurance>

²⁰ <http://www.bsv.admin.ch/themen/ahv/00011/01300/index.html?lang=fr>

* Kosova dhe vendet e rajonit

Në vendet e ndryshme përgjatë kohëve kryesisht janë zhvilluar dy sisteme kryesore pensionale, 1. Pay-As-You-Go (PAYG), dhe sistemi i bazuar në investime apo i definuar. Sistemi PAYG ndryshe njihet edhe si sistem solidar apo i gjeneratave, ku mjetet e mbledhura nga kontribuesit shfrytëzohen direkt për pensionistët aktual²¹.

Në Kosovë pas luftës dhe pas vjedhjes së fondit pensional nga Serbia, me një Rregullore të UNMIK-ut, sistemi pensional i gjeneratave, u zëvendësua me sistemin investimeve. Ky ndryshim bëri një prerje në mes kontribuesve të cilët kanë kontribuar për shumë vite në fondin e Jugosllavisë dhe kontribuesve të ardhshëm në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës. Ish -kontribuesit në fondin e kaluar u përjashtuan nga e drejta për t'i realizuar pensionet, për të cilat kishin kontribuar shumë vite me radhë. Në vend të pensionit u morë vendim që ata të marrin disa ndihma/ pensione të cilat nuk ishin të shkallëzuara në proporcionin e kontributeve as përvojës së punës, por i përfshinte të gjithë personat të cilët kanë mbushur moshën 65 vjeq, pa dallim gjinie.

Sistemi pensional i organizuar në tri shtylla në Kosovë, kategorinë e ish kontribuesve e rregullon në shtyllën e parë, për të cilën obligohet Qeveria të paguaj nga buxheti i shtetit. Kjo ka ndikuar që një pjesë e madhe e buxhetit të varfër të alokohet për çështje sociale, dhe njëkohësisht pensionet e moshës në Kosovë të jenë më të ulëtat në rajon.

Vendet të cilat dolën pas shpërbërjes së ish federatës Jugosllave, kanë bërë zgjidhje të ndryshme lidhur me sistemet e tyre përkatëse të pensioneve. Disa prej tyre vazhdojnë të kenë modelin e vjetër PAYG, kurse disa të tjera kanë reformuar këtë model dhe kanë kaluar në sistemin e investimeve.

Sllovenia - Aplikon një model me tri shtylla, ndërsa model bazë është ai PAYG, pra gjenerata paguan për gjeneratën. Shtylla e dytë është ajo e investimeve e cila është e obligueshme vetëm për një numër të caktuar të punëtorëve dhe shtylla e tretë janë pensionet suplementare private. Është shumë interesante se në këtë vend Qeveria ka propozuar një reformë në sistemin pensional për të kaluar nga modeli PAYG në atë të investimeve dhe disa ndryshime të tjera, mirëpo në referendum kjo gjë është refuzuar me 70% të votave²². Pra modeli i investimeve nuk është treguar shumë i dëshiruar atje për një mori arsyesh. Megjithatë rreth 2/3 e të gjithë të punësuarve janë të kontribues në shtyllën e dytë, gjë e cila është obligative për të punësuarit në sektorin publik dhe personat me rrezikshmëri të lartë në vendet e punës²³.

Mosha e pensionimit për meshkuj është 65 vjeq, kurse për femra 63 nëse ata kanë kontribuar minimalisht për 15 vite. Të punësuarit paguajnë 15.5% të pagës bruto si kontribute, ndërsa punëdhënësit 8.85%, kurse të vetë punësuarit paguajnë 24.35%²⁴.

²¹ <http://www.docstoc.com/docs/23725996/Pension-Funds-and-Capital-Markets-in-Macedonia>

²² http://www.ipe.com/news/slovenian-government-defeated-in-pension-reform-referendum_40856.php

²³ http://www.socialprotection.eu/files_db/911/asisp_ANR10_Slovenia.pdf

²⁴ <http://www.en.kapitalska-druzba.si>

Kroacia – nga viti 2002 po ashtu edhe Kroacia ka modelin pensional tri shtyllës, dhe kombinohet me të dy modelet PYAG dhe atë investues. E veçanta në këtë vend është se kontributet e detyrueshme e që ndalen nga secili kontribues, një pjesë e tyre shkon direkt për shtyllën e parë, tek pensionistët aktual. Ky vend e ka të liberalizuar shtyllën e dytë dhe këtu kemi më shumë se një operatorë i cili menaxhon me kontributet e kapitalizuara. Individët të cilët kanë moshën mbi 50 vjeçare dhe të cilët nuk mund të kapitalizojnë mjete të mjaftueshme, lihen në shtyllën e parë PAYG. Mosha e pensionimit është 65 vite për meshkuj, 60 për femra, me minimum 15 vite përvojë pune²⁵.

Maqedonia - në vitin 2005 ka reformuar sistemin pensional, dhe ka kaluar nga modeli paraprak në atë të investimeve, duke e ruajtur modelin paraprak për disa kategori të kufizuara si tranzicion deri sa të kalohet në tërësi në modelin e investimeve. Në Maqedoni po ashtu sikurse në Kroaci, shtylla e dytë është e liberalizuar dhe më shumë se një operatorë menaxhon kontributet e kapitalizuara. Mosha e pensionimit në këtë vend është 64 vite për meshkuj, 62 për femra me së paku 15 vite përvojë të punës.

	Masa e kontributeve ne %	Shtylla I	Shtylla II
2009	19	12,35	6,65
2010	17,5	11,38	6,13
2011	15	9,75	5,25

Shembull nga Maqedonia ²⁶

Vendet e tjera si, Mali i Zi, Shqipëria, Bosnja e Hercegovina dhe Serbia janë këshilluar dhe e kanë filluar procesin e reformimit të skemës pensionale, për të kaluar nga skema PAYG në skemën e bazuar në investime ose atë të definuar²⁷.

5. Reforma pensionale që duhet aplikuar në Kosovë

Me qëllim të krijimit të një sistemi pensional të mirëfilltë tri-shtyllësh, reformimi i sistemit aktual pensional në Kosovë duhet të jetë një ndër prioritetet e institucioneve të Kosovës me qëllim që tranzicioni në mes sistemit të vjetër pensional dhe sistemit të llogarive kursyese që po ndërtohet në Kosovë të jetë sa më i lehtë dhe i padëmshëm për shtesat e caktuara të shoqërisë.

Kosova përkundër problemeve me modelin e saj të pensioneve në thelb nuk ka nevojë të ndryshoj shumë për sa i përket shtyllës së dytë dhe aq më pak shtyllën e tretë. Nevojat më të mëdha e njëkohësisht edhe pakënaqësitë të cilat sa vinë e shtohen janë me shtyllën e parë, përkatësisht me pensionet e moshës për personat të cilët kanë kontribuar në fondin e kaluar të pensioneve. Tek shtylla e parë e pensioneve, është e domosdoshme që të rishkohet baza legale me qëllim që të caktimit të kontributit shtesë në tregun e punës. Përveç pagesave aktuale të cilat janë obligative në trust në llogarinë e secilit, çdo i punësuar dhe punëdhënës duhet të paguajnë nga një përqindje shtesë në një fond të posaçëm që do të shkonte në favor të shtyllës së parë.

²⁵ <http://www.iopsweb.org>

²⁶ www.mtsp.gov.mk.

²⁷ Raportit vjetor të Trustit të Pensioneve të Kosovës

Në të gjitha vendet e rajonit, shtylla e I dhe II janë të ndërlidhura gjë e cila sistemin pensional e bënë të kombinuar pasi që një pjesë e kontributeve, paguhen edhe për pensionistët aktual krahas kontributeve individuale të secilin person. Kjo është e domosdoshme duke pasur parasysh pa mjaftueshmërinë e mjeteve buxhetore për të financuar të tërë pensionet nga buxheti i shtetit, i cili edhe ashtu është i stërngarkuar me pagesa për kategoritë sociale dhe me gjasë nuk do të mund të duronte edhe një rritje substanciale për pensionistët aktual.

Shumë ekspert të fushës e shohin të nevojshme edhe ri-shikimin e Ligjit mbi pensionet në Kosovë (ndryshim plotësim i Rregullores së UNMIK-ut 2005/20) për sa i përket formës së menaxhimit të mjeteve të fondit pensional. Duke marr parasysh politikat konservatore të investimit të mjeteve të Trustit dhe mos efikasitetin e pritshëm në investime, kur merret për bazë investimet me kthime jo shumë profitabile, propozohet që shtylla e dytë të liberalizohet (të hapet tregu) në mënyrë që konkurrenca të rrisë produktivitetin në këtë fushë dhe kontribuesve t'u jap më shumë zgjedhje ndërmjet operatorëve²⁸. Trusti ka hapësirë për ta ndryshuar formën e punës, taksa menaxhuese është shumë e lart, po të ishte e liberalizuar kjo shtyllë automatikisht do të ulej taksa menaxhuese²⁹. Kjo njëherit është edhe praktikë në disa vende të rajonit të cilët kanë të liberalizuar shtyllën e dytë.

Argument tjetër në favor të këtij liberalizimi është edhe fakti se operatori aktual i vetëm në Kosovë nuk garanton një kthim minimal në investime p.sh. 3% në vit, dhe për shembull nëse kjo nuk bëhet, një operator privat do të detyrohej ta mbuloj këtë "humbje" nga kapitali i vet. Fondet aktuale të kurismeve në Trust nuk janë të siguruara, dhe në rast të turbulencave financiare si në vitet paraprake as kush nuk mund të garanton se kontributet e punëtorëve do të jenë proporcionale me shportën në Kosovë.³⁰

Opinion të kundërt me këtë ndajnë përfaqësuesit e Trustit të cilët këmbëngulin se nuk është e nevojshme të liberalizohet kjo shtyllë për shkak se e gjithë kjo vetëm sa do të rëndonte kontribuesit të cilët do ta paguanin këtë gjë me rritje të tarifës menaxhuese. Sipas tyre kjo praktik nuk është treguar gjithëaq e suksesshme as në Kroaci apo Maqedoni pasi herë një vit herë vitin tjetër një operator ka pasur një rritje simbolike në kthimet e investimeve, ndërsa krejt kjo ka bërë që vetëm tarifa menaxhuese të jetë me e lartë. Sipas tyre kjo tarifë në Kosovë është me e ulëta në rajon dhe po ashtu po planifikohet të ulet edhe më tutje, si rezultat i rritjes së numrit të kontribuesve në fondin e Trustit. Kjo sipas tyre do të ndikonte që të gara në marketing të jetë më agresive për të tërhequr sa më shumë më shumë kontribues në njërin apo fondin tjetër, dhe mjetet që do të shpenzoheshin në këtë fushatë do të ishin të gjitha në dëm të kontribuesve. Sipas tyre liberalizimi do të ndikonte që këta operatorë të aplikojnë taksa të ashtuquajtura të fshehura duke ndalur taksa nga fondet hyrëse dhe dalëse, gjë e cila është praktik në këto vende por që nuk ndodhë në Kosovë.

²⁸ Intervistë personale, Dardan Sejdiu – Drejtor i Fondit Kosovaro-Slloven

²⁹ Intervistë personale Alban Hashani – Drejtor i hulumtimeve në Institutin Riinvest.

³⁰ Intervistë personale, Dardan Sejdiu – Drejtor i Fondit Kosovaro-Slloven

6. Rekomandimet

- Kontributet pensionale të rriten nga sa janë tani, për të mundësuar që një pjesë e këtyre mjeteve të shkojnë për kategorinë e pensionistëve aktual. Kjo njëherit do të ndikonte që modeli aktual i definuar të kombinohet me atë PAYG, për t'i lehtësuar transicionin kategorive të pensionistëve që nuk përfitojnë nga ky fond;
- Pensionet të jenë të përshkallëzuara varësisht nga kontributi në fond dhe përvoja e punës së një qytetari;
- Moshë e pensionimit të mos jetë e njëjtë për të dy gjinitë, femrat duhet të dalin në pension para moshës 65 vjeç;
- ATK dhe Trusti, të ndërmarrin fushatë për të luftuar informalitetin, duke i detyruar punëdhënësit të lajmërojnë punëtorët e tyre, që të mund të paguhen kontributet pensionale;
- Trusti do të duhej të investonte në marketing për t'i informuar/edukuar qytetarët rreth rëndësisë së kontribuimit në fondin pensional dhe pasojat eventuale që dalin nga mos pagimi i këtyre kontributeve;
- Shtylla e dytë, do të duhej të liberalizohej, në mënyrë që qytetarët të kenë të drejtë të zgjedhin se ku duan t'i investojnë mjetet e tyre, duke bartur përgjegjësinë për kthimin e mjeteve dhe riskun eventuale;
- Për të plotësuar sa më shumë bazën legale në sferën e sistemit pensional duhet të nxjerrën edhe ligjet apo dispozita të cilat rregullojnë çështjen e pensionimit suplementar, invalidor etj;
- Qeveria duhet të plotësojë bazën legale dhe të krijojë kushtet e nevojshme për të mundësuar investimin e mjeteve të fondit pensional në zhvillimin ekonomik të vendit;
- Do të duhej që edhe kategoritë e personave të vetëpunësuar, bujqit apo të gjithë ata që në ndonjë formë ekonomizojnë, të paguajnë për këto kontribute, për të mundur që sa më pakë njerëz në të ardhmen të mbesin jashtë përfitimit nga sistemi pensional;
- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, për rastet e vdekjeve të pensionistëve të ndajë shumën e tri pensioneve, në emër të mbulimit të shpenzimeve të varrimit, për të inkurajuar familjarët në lajmërimin e personave të vdekur.

7. Burimet:

16

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Intervistë personale, Dardan Sejdiu – Drejtor i Fondit Kosovaro-Sloven

Intervistë personale, Alban Hashani – Drejtor I hulumtimeve në Institutin Riinvest.

Intervistë personale, Sami Salihu, Drejotr i Departamentit të Administratës Pensionale

Intervistë personale, Agron Krasniqin, Zv-Drejtor në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës

Intervistë personale, Zineta Daci, Oda Ekonomike e Kosovës

Raportit vjetor të Trustit të Pensioneve të Kosovës 2010

Raporti i monitorimit të Punës së Kuvendit të Kosovës – Instituti Demokratik i Kosovës (KDI)/ www.kdi-kosova.org

<http://esk.rks-gov.net> (Të dhënat e Entit të Statistikave e Kosovës për vitin 2007).

<http://www.justlanded.com/english/Switzerland/Switzerland-Guide/Jobs/Old-age-insurance>

<http://www.bsv.admin.ch/themen/ahv/00011/01300/index.html?lang=fr>

<http://www.docstoc.com/docs/23725996/Pension-Funds-and-Capital-Markets-in-Macedonia>

<http://www.en.kapitalska-druzba.si>

http://www.socialprotection.eu/files_db/911/asisp_ANR10_Slovenia.pdf.

http://www.ipe.com/news/slovenian-government-defeated-in-pension-reform-referendum_40856.php

<http://www.unmikonline.org>

<http://www.assembly-kosova.org/>

www.iopsweb.org

www.coe.int

www.mtsp.gov.mk.

CONSTRUCTION OF THE PENSION SYSTEM in Kosova



 **KDI**
Instituti Demokratik i Kosovës
Kosova Democratic Institute
www.kdi-kosova.org

Content:

18

1.	Introduction	19
2.	Current situation and legal basis that cover this area	20
